

URDHËR
Nr. 129, datë 20.2.2026

PËR DELEGIM TË PËRKOSSHËM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 75/2019, “Për Rininë”, i ndryshuar; të vendimit nr. 598, datë 15.10.2025, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 969, datë 2.12.2020, të Këshillit të Ministrave, ‘Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij’”, si dhe të Rregullores së Funksionimit të Këshillit Kombëtar të Rinisë, dhe me qëllim garantimin e funksionimit efektiv, përfaqësimit të balancuar dhe rritjes së rolit të të rinjve në vendimmarrje,

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të bashkëkryetari, z. Dashnor Veizaj, të zgjedhur nga të rinjtë në Këshillin Kombëtar të Rinisë, për ushtrimin e këtyre kompetencave:

a) thirrjen dhe drejtimin e mbledhjeve, në mungesën time, të Këshillit Kombëtar të Rinisë, sipas rendit të ditës të dakordësuar;

b) koordinimin e grupeve të punës dhe ndjekjen e zbatimit të vendimeve të miratuara;

c) ushtrimin e çdo kompetence tjetër funksionale që lidhet me mbarëvajtjen e punës së Këshillit Kombëtar të Rinisë, përveç atyre që, sipas ligjit, përbëjnë kompetencë ekskluzive të ministrit.

2. Ky delegim hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe është i vlefshëm deri në nxjerrjen e një urdhri të dytë.

3. Ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Mbështetjes për Rininë, Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe Sektori i Arkiv-Protokollit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
Blendi Gonxhja